


**Avokati i Popullit në sistemin e  
mbrojtja kundër diskriminimit**



# PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE



## PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

### HISTORIKU

Pas analizimit të gjendjes sëpërgjithshme, organet e pavarura gjerësisht janëtënjohura si komponentëkyçetë një sistemi demokratik të qëndrueshëm dhe efikas, të zhvilluar në themelet e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë. Në këtë rast është Zyra e Avokatit të Popullit. Nga njëra anë, ato ofrojnë mjete shtesë të përfaqësimit dhe mbrojtjes së qytetarëve dhe të drejtave të tyre, ndërsa nga ana tjetër ofrojnë mekanizëm të fuqishëm të kontrollit dhe ekuilibra që lehtësojnë kontrollin efikas dhe efektiv mbi degën ekzekutive të pushtetit. Për këtë arsye, organet e pavarura shpesh përmendën si dega e katërt e pushtetit e cila është përgjegjëse jo vetëm për mbrojtjen e tëdrejtave të qytetarëve, por gjithashtu edhe për mbikëqyrjen e punës së institucioneve tëpushtetit ekzekutiv. Për të qenë të sigurt për mbështetjen dhe përfaqësimin e duhur të qytetarëve, duhet tëkrijohen kushtet adekuate për të ofruar studim, lojë dhe zhvillim të përgjithshëm personal. Në masë të barabartëështë edhe nevoja për krijimin e kushteve dhe mundësive që inkurajojnë dhe lehtësojnë qytetarët për pjesëmarrje aktive në jetën më të gjerë sociale, ligjore dhe ekonomike të vendit.

Zyra e Avokatit të Popullit është përfshirë në shkallë të ndryshme të suksesit në promovim të të drejtave të njeriut në faza tëndryshme të zhvillimit kombëtar. Pra, kjo përmbledhje e politikave ofron substancë dhe rekomandime sidomos për përpjekjet e zyrave lokale. Përmbledhja e politikave ofron parime udhëzuese në përputhje me kërkesat për të shfrytëzuar opinionet, iniciativat, resurset dhe përvojat e të punësuarve që punojnë në zyrën rajonale të Mitrovicës dhe zyrën qendrore të Avokatit të Popullit në Prishtinë.

### HYRJE

Ky dokument dhe përpjekjet e bëra në përgatitjen e dokumentit kanë për qëllim largimin e debatit mbi çështjet e të drejtave të njeriut nga debati politik dhe teoria e të drejtave të njeriut, dhe për të identifikuar sfidat dhe interesat e përbashkëta në mes të qytetarëve të vërtetë dhe përpjeke për të gjetur zgjidhje, dhe për të promovuar punën dhe përpjekjet e Avokatit të Popullit si një institucion i pavarur dhe kushtetues në promovim dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Ky dokument dhe gjetjet e rekomandimet e tij vijnë në një moment vendimtar për komunitetin serb. Gjatë hulumtimit, qytetarët shfrytëzuan rastin të dalin përpara dhe tëofrojnë komente për zyrën lokale dhe qendrore të Avokatit të Popullit dhe roli i tij është pozitiv në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve, kurse rekomandimet janëparaqitura si më poshtë:

- (i) Të monitorojë, rishikojë dhe këshillojë qeverinë lokale për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e rekomandimeve e dhëna nga Zyra e Avokatit të Popullit;
- (ii) Të sigurojë dhe të garantojë me ligj që rekomandimet e dhëna nga zyra e Avokatit të Popullit do të ndiqen pa asnjë vonesë.
- (iii) Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile që merren me sundimin e ligjit dhe Zyrën e Avokatit të Popullit.

## METODOLOGJIA

Dokumenti i përmbledhjes së politikave është rezultat i përpjekjeve të bëra nga konsultimet e shumta që kanë përfshirë pjesëmarrjen aktive, të papenguar dhe të përkushtuar të një sektori të gjerë të palëve të interesuara të cilat kanë marrë pjesë gjatë zbatimit të projektit dhe punëtorive të mbajtura në veri të Mitrovicës, në një proces që ka filluar në fillim të muajit dhjetor të vitit 2017. Duke u nisur nga bashkëveprimi dhe shkëmbimi i përvojave, ideve dhe koncepteve, lindi ideja që duhet hartuar një përmbledhje të politikave për të mirën e kësaj dhe të gjeneratave të ardhshme të qytetarëve në Mitrovicë dhe në tërë Kosovën. Gjatë përgatitjes së kësaj përmbledhje të politikave, janë kryer konsultimet aktive me zyrën e Avokatit të Popullit në Prishtinë dhe në Mitrovicën e Veriut dhe me OJQ-të, mediat dhe individët e përmendur në seksionin e vlerësimeve të veçanta.

## VLERËSIMET E VEÇANTA

Vlerësimi këtu i është dhënë QOSh-së, organizatave të mediave, organizatave studentore, përfaqësuesve dhe Departamenteve të Pushtetit Lokal që pranuan të marrin pjesë në këtë hulumtim, si dhe të gjithë individëve të cilët kanë marrë pjesë aktivisht në punëtori, për kontributin e tyre të dhënë për Përmbledhjen e Politikave. Ato organizata/departamente përfshijnë:

- OJQQendra e avokimit për kulturën demokratike (ACDC)
- OJQQendra për orientim shoqëror
- Departamentet komunale për rini
- OJQ COD
- OJQ Human Centre Mitrovicë
- TV MIR Leosaviq
- Radio Kontakt Plus
- Nën zyra e Avokatit të Popullit në Mitrovicë
- Zyra e Avokatit të Popullit në Prishtinë
- KoSSev Media Portal

## KAPITULLI 1

### PËRKUFIZIMI

Kushtetuta dhe paketa ligjore për të drejtat e njeriut kanë hyrë në fuqi në vitin 2015 (Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligji Nr.05/L-020 për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Ligji Nr. 05/L-021 për barazi gjinore), parashohin një gamë të gjerë të kompetencave të Avokatit të Popullit, të cilat rrjedhin nga aktivitetet promovuese, nëpërmjet hulumtimeve në fushën e diskriminimit, të trajtimittë ankesave të individëve të cilët pretendojnë të jenë viktimat të diskriminimit dhe marrjen e një roli aktiv në procedurat kundërvajtëse për mbrojtjen nga diskriminimi. Në këtë kuptim, kompetencat ligjore të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në fushën e mbrojtjes kundër diskriminimit janë në përputhje me standardet ndërkombëtare relevante me punën e organeve për mbrojtjen e barazisë gjinore dhe të të drejtave të njeriut.

Sipas nenit 5 të Rregullores Nr. 01/2016 për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, 2016, ([http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Rregullorja\\_01-2016\\_ang\\_528820.pdf](http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Rregullorja_01-2016_ang_528820.pdf) and [Regulation 02/2016](#)), struktura organizative e IAPK, përbëhet nga:

“shërbimet profesionale, që përfshijnë 5 sektorë, brenda të cilëve janë 7 departamente: Departamenti për Pranimin dhe Administrimin e Ankesave: Departamenti për Hetimin e Ankesave: Departamenti për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Departamenti për Mbrojtje të të Drejtave të Fëmijëve, Departamenti për Parandalimin e Torturës, Departamenti i Çështjeve Ligjore, dhe Departamenti për Bashkëpunim, Raportim dhe Promovim të të Drejtave të Njeriut. Departamentet janë themeluar dhe kanë filluar veprimtarinë e tyre gjatë vitit 2017.

## KAPITULLI 2

### QËLLIMI I POLITIKAVE

Direktivat e Bashkimit Evropian mbi mos diskriminimin kërkojnë krijimin e një organi për mbrojtjen e barazisë që do të kishte juridiksion minimal të detyrueshëm në luftën në terren kundër diskriminimit. Këto direktiva parashohin detyrimin për të krijuar një organ përgjegjës të cilin do të përfshinin "ofrimin e ndihmës së pavarur për viktimat e diskriminimit kur paraqesin ankesë ndaj diskriminimit", "kryerjen e hulumtimeve të pavarura" dhe "publikimin e raporteve dhe rekomandimeve të pavarura" mbi diskriminimin. (Neni 228 i Traktatit mbi Funkcionimin e Avokatit të Popullit Evropian). Duke përdorur formulime të tilla të gjera, ligji i BE-së lë diskrecion të konsiderueshëm shteteve për të vendosur se cilat kompetenca specifike do t'u caktohen këtyre organeve, e në këtë rast zyrës së Avokatit të Popullit. Thelbi qëndron aty se këto organe, ndër të tjera, duhet të ofrojnë njëlloj të ndihmës juridike vizuale për viktimat e

diskriminimit dhe t'i ndihmojnë ato në realizimin e të drejtave të tyre dhe në fund t'iu rekomandojnë veprimet institucioneve.

## KAPITULLI 3

### KUSHTET PËR PUNË EFEKTIVE

Si dy tregues kyç për vlerësimin e organeve vendore të përfshira në mbrojtjen e barazisë, duhet theksuar se "pavarësia" dhe "efektiviteti" janë faktorët më të rëndësishëm, me ç'rast treguesi i parë është në fakt çelësi i tjetrit. Pavarësia nënkupton mundësinë e këtyre organeve për të siguruar dhe organizuar burimet e tyre njerëzore, mjetet e tyre financiare dhe prioritetet e tyre në mënyrën të cilën ata e konsiderojnë se më së miri i përshtatet cilësisë së aktiviteteve të tyre, për të vendosur në mënyrë të pavarur për çështjet e personelit, për të përcaktuar prioritetet e tyre dhe për të përdorur fuqitë e tyre kur dhe si i konsiderojnë të nevojshme. Në anën tjetër, efektiviteti nënkupton që këto organe janë në gjendje të zbatojnë të gjitha funksionet dhe kompetencat e tyre në një mënyrë e cila siguron një ndikim të vërtetë në fenomenin e diskriminimit dhe pabarazisë, e që do të thotë se rekomandimet e tyre ndiqen dhe zbatohen pa asnjë vonesë.

## KAPITULLI 4

### ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT NË MBROJTJEN SISTEMATIKE NDAJ DISKRIMINIMIT

Në përgjithësi, kompetencat ligjore të Avokatit të Popullit të Kosovës në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi janë kryesisht në përputhje me direktivat e BE-së, standardet ndërkombëtare dhe praktikat relevante krahasuese.

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) merret me çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas fuqive dhe kompetencave të parapara nga Ligji për Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi. (Ligji Nr. 05/L-019, Ligji Nr. 05/L-021).

Për më tepër, Avokati i Popullit është një mekanizëm i barazisë për promovimin, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë pa diskriminim mbi bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore (Ligji Nr. 05/L-020) dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

IAP është një institucion i pavarur i cili udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, përparësisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit.

Sipas dispozitave të nenit 9 të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, IAP ka këto kompetenca:

- pranon dhe heton ankesat nga çdo person fizikë apo juridik,

- ofron opinione dhe rekomandime mbi rastet konkrete të diskriminimit dhe po ashtu mund të filloj hetimet ex-officio;
- ofron asistencë viktimave të diskriminimit në bërjen e ankesave kundër diskriminimit dhe ofron informatat e domosdoshme personave që kanë paraqitur një ankesë për diskriminim në lidhje me të drejtat e tyre,
- detyrimet dhe mundësitë e gjykatës, si dhe mjetet tjera mbrojtëse;
- u drejtohet organeve të prokurorisë dhe të hetimit direkt me një kërkesë për fillimin e hetimit të kundërvajtjeve dhe veprave penale dhe kërkon fillimin e procedimit disiplinor të zbatueshëm;
- informon publikun për rastet e diskriminimit dhe ndërmerr masa për promovimin e barazisë, të të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimit;

Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e 'mikut të gjykatës' (amicus curiae), i cili monitoron zbatimin e këtij ligji dhe inicion ndryshimet dhe plotësimet e dispozitave për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi;

IAP, gjithashtu mund të ofrojë këshilla, udhëzime dhe mbështetje për subjektet e sektorit publik dhe privat, për praktikën më të mira në promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe luftimin e diskriminimit në baza të mbështetura nga Ligji përkatës për Barazi Gjinore.

IAP ofron opinione në hartimin e akteve normative për mbrojtje nga diskriminimi; mbledh të dhëna statistikore dhe të tjera, kryen studime, hulumtime dhe trajnime që kanë të bëjnë me diskriminimin; bashkëpunon me partnerët social, organizata joqeveritare që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me mekanizmat përkatës të vendeve të tjera që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe me institucionet dhe komunitet fetare të regjistruara në Republikën e Kosovës; së paku një herë në vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës dorëzon raport për zbatim të këtij Ligji dhe po ashtu mund të hartoj raporte të veçanta lidhur me implementimin e tij; Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e një mikut të gjykatës (amicus curiae) në procedurat lidhur me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës gjithashtu ka një rol më të gjerë promovues dhe parandalues në luftën kundër diskriminimit. Përveç kësaj, ai ka rol në mbrojtjen e njerëzve në raste specifike; ky institucion gjithashtu ka kompetenca më të gjera në këtë fushë. Një pjesë e rëndësishme e kompetencave është përqendruar në veprim parandalues - edukim dhe aktivitete promovuese në kontekst të së drejtës për të përjashtuar diskriminimin. Në këtë kuptim, Institucioni i Avokatit të Popullit mbledh dhe analizon të dhënat statistikore mbi rastet e diskriminimit në Kosovë, me vetiniciativë kryen hulumtime në fushën e diskriminimit, të cilat i dorëzohen entitetit përgjegjës dhe organeve shtetërore parlamentare në baza vjetore, dhe nëse është e nevojshme, një raport i jashtëzakonshëm mbi shfaqjen e diskriminimit, informon publikun për shfaqjen e diskriminimit, ngritëvetëdijesimin për çështjet në lidhje me diskriminimin në shoqëri, rekomandon nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshime dhe plotësime të ligjeve në fuqi dhe nxjerrjen ose plotësimin dhe ndryshimin e akteve administrative dhe nënligjore nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës, ofron këshilla legislative dhe

ekzekutive dhe propozon zgjidhje ligjore dhe zgjidhje tjera, dhe promovon politika dhe praktika që kanë për qëllim të sigurojnë trajtim të barabartë.

## KAPITULLI 5

### • TRAJTIMI I ANKESAVE – PARIMET THEMELORE

Procedura për ankesat individuale përballë Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës ka shumë përparësi - është falas, e thjeshtë dhe do të thotë ndihmë miqësore e përgjegjshme. Kjo procedurë, e cila nuk kërkon asistencë profesionale ligjore, gjithashtu është aspekti më i rëndësishëm i mbrojtjes kundër diskriminimit që sigurojnë individët në institucionet e cekura. Viktimat e diskriminimit, individët dhe personat juridikë, mund të apelojnë për ankesat e tyre drejtpërsëdrejti duke kontaktuar zyrën e Avokatit të Popullit (me postë, telefon, email, faks ose duke e dorëzuar personalisht), e cila, nëse është e nevojshme, ofron ndihmë në plotësimin e një formulari special të paraparë për atë, sqaron të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe mundësitë e rishikimit gjyqësor dhe mbrojtje të tjera në dispozicion për individ, duke përfshirë referimet tek organet dhe organizatat që mund t'i përfaqësojnë ato në procedurën e mbrojtjes gjyqësore. Në këtë mënyrë, një ankues në një mënyrë të qasshme është ndihmuar nga këshilltari ligjor për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe mbrojtjen kundër diskriminimit, përveç kësaj klienti ndihmohet në formulimin e kërkesave dhe pretendimeve të tij në mënyrën më të mirë të mundshme dhe përdor mënyra të tjera të mbrojtjes, të cilat, në varësi të rrethanave të veçanta, mund të nënkuptojë procedura gjyqësore, administrative, penale ose kundërvajtëse, si dhe adresimin tek inspektimet kompetente.

Procesi i mbrojtjes përballë Institucionit të Avokatit të Popullit përshtatet me nevojat e grupeve të varfra dhe të marginalizuara të popullsisë. Në këtë mekanizëm mbrojtës, si rregull, nuk ka nevojë për një përfaqësues ligjor profesional, sikurse edhe theksohet shpesh në nivel ndërkombëtar dhe lokal, si një nga avantazhet kryesore të procedurës para organeve mbrojtëse që mbrojnë barazinë, të drejtat ligjore ose të drejtat e njeriut. Mjafton që personi i cili beson se është i diskriminuar ose që konstaton se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut, t'i drejtohet Avokatit të Popullit të Kosovës, i cili përmes një bisede me ankuesin dhe përmes përdorimit të mekanizmave hetues identifikon juridiksione, mbledh informacion, dëshmi, deklaratat, dhe në bazë të kësaj mund të identifikojë një shkelje të së drejtës. Duke marrë parasysh se ky mekanizëm është pa pagesë, në shumicën e rasteve është lehtësisht i disponueshën për viktimat të diskriminimit, duke përfshirë grupet e varfra dhe të marginalizuara. Kjo është shumë e rëndësishme duke pasur parasysh faktin se "shumica e qytetarëve që i drejtohen institucionit janë në nevojë (ligjore) për ndihmë ose janë në gjendje për nevojë sociale".

Sipas nenit 9 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Institucioni i Avokatit të Popullit ka autoritetin të hetojë ose me vetë-iniciativë (ex-officio) të inicioj rastin kur ekziston dyshimi se ka pasur diskriminim të kryer nga subjektet publike. Sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Avokatin e Popullit (neni 9), të gjitha institucionet e tjera që ushtrojnë pushtet legjitim janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe t'i përgjigjen kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kjo nënkupton kërkimin e informatave dhe deklaratave të personave juridikë kundër të cilëve janë iniciuar procedurat. Të gjitha institucionet e qeverisë dhe personat e tjerë juridikë dhe individë janë të detyruar t'i përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit jo më vonë se 30 ditë nga pranimi i kërkesës dhe të ofrojnë të gjitha të dhënat dhe dokumentet e kërkuara. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit, ekziston një detyrë e bashkëpunimit me zyrën e Avokatit të Popullit për sa i përket mundësisimit të qasjes, për të gjitha dosjet ose dokumentet.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, gjithashtu nxjerr rekomandime me masa për të eliminuar diskriminimin dhe për monitorimin e zbatimit të tyre. Nëse rastet nuk janë zgjidhur në fazën e hetimit dhe nëse në bazë të informacionit të marrë gjatë rrjedhës së hetimit, është konstatuar se ka ndodhur diskriminimi, Avokati i Popullit jep një rekomandim me qëllim të parandalimit dhe zhdukjes së diskriminimit, duke kërkuar korigjimin e shkeljes së të drejtave dhe propozimin e masave (individuale dhe/ose të përgjithshme) për heqjen e tyre, me ç'rast zakonisht ofrohet një afat prej 30 ditësh. Pas nxjerrjes së rekomandimeve, rasti nuk është mbyllur dhe ekziston një sistem dhe mbështetje teknike për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve.

Gjatëperiudhës së projektit, ekipi i ACDC në projekt ka pasur disa takime me zyrën e Avokatit të Popullit dhe departamentet ligjore të tij, takimet janëmbajtur në gusht të vitit 2017 me Avokatin e Popullit Z. Hilmi Jashari, në dhjetor dhe janar të vitit 2018 me Znj. Miljana Scekcic nga zyra e Avokatit të Popullit në Mitrovicën e Veriut, në muajin korrik dhe gusht 2018 me Znj. Marija Radulovic zëvendës Avokate e Popullit dhe në qershor dhe shtator 2018 me vet Avokatin e Popullit Z. Hilmi Jashari, me Znj. Miljana Scekcic nga departamenti ligjor i Mitrovicës së Veriut si dhe me Isa Hasanin Drejtorin e Departamentit për Pranim dhe Administrim të Ankesave. Për më tepër, vlen të theksohet se takimet me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit Znj. Miljana Scekcic janë mbajtur në baza mujore për të pasur njëpasqyrë të qartë të punës së zyrës dhe njohurive të qytetarëve sëçfarë shërbime mund të ofroj zyra me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Në bazë të informatave të marra nga zyrtarët e Zyrës së Avokatit të Popullit, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, zyra e Avokatit të Popullit ka pranuar 1,010 ankesa nga qytetarët e Kosovës. Sipas zyrës së Avokatit të Popullit, nga numri i përgjithshëm, 566 ankesa nuk ishin tëpranueshme në bazë të nenit 21 dhe 22 tëLigjit për Avokatin e Popullit dhe 444 ankesa u pranuar dhe janëpërcjellë tek departamentet e ndryshme. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2018, Avokati i Popullit ka zgjidhur 121 raste me rezultat pozitiv, ndërsa 323 raste janë në proces të zgjidhjes. Me qëllim tëprezantimit më të mirë të punës pozitive të zyrës së Avokatit të Popullit, zyra është pajtuar të ofrojëdisa raste që kanë informata në lidhje me shumanshmërinë e rasteve që janë paraqitur nga qytetarët dhe janë shqyrtuar nga zyra e Avokatit të Popullit përballë gjykatave tëndryshme.

### **1. Ankesa nr. 344/2018-kundër komunës së Lipjanit.**

Me datë 28 maj 2018, Institucioni i Avokatit të Popullit përmes adresës zyrtare elektronike të IAPK ka pranuar një apel nga një grup i qytetarëve.



“Po ju shkruaj në lidhje me apelin kundër "Gjimnazit Ulpiana" në Lipjan, i cili ka kërkuar nga studentët 2 euro për riparimet e pretenduara”.

Zakonisht, gjatë periudhës së rregullt të vitit shkollor, nxënësit paguajnë dëmin që shkaktojnë me pagesat për detyrimet e tjera të shkollës, prandaj pagesat shtesë janë të padrejta.

Pasi që këshilltari i Avokatit të Popullit kontaktoi zyrtarët komunal dhe shpjegoi rastin dhe kërkesën për pagesa shtesë, zyrtarët komunal e tërhoqën këtë kërkesë dhe me kërkesë nga apeluesit çështja u mbyll me rezultat pozitiv.

Avokati i Popullit, duke u thirr nënenin 21 pika 1.5 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019 dhe pasi që rasti është zgjidhur në mënyrë pozitive, Avokati i Popullit me datë 05.07.2018 vendosi të mbyll hetimet në lidhje me çështjen në fjalë me rezultat pozitiv.

## **2. Ankesa nr. 201/2018 kundër Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti.**

Me datë 28 mars 2018, Institucioni i Avokatit të Popullit pranoi një apel nga apeluesi në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave përballë Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega Viti për rastin P.br.541/16 për uzurpim të pasurisë së patundshme në fshatin Pozharan, komuna e Vitisë. Pas adresimit tek pala përgjegjëse lidhur me këtë apel, sipas nenit 21 pika 1.5 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05 L-019, IAP mori informata se çështja ishte zgjidhur dhe një urdhër për zhvendosjen e uzurpatorit ishte lëshuar.

Avokati i Popullit me datë 11 qershor 2018 vendosi të përfundojë hetimin e mëtejshëm për këtë rast pasi që çështja në fjalë u zgjidh me sukses.

## **3. Rasti ex officio Nr.412/2017/ Ministria e Arsimit (MA)**

Në baza të informatave të siguruara nga tereni me datë 21 qershor 2017, Avokati i Popullit hapi rastin “Ex officio” në lidhje me Vendimin nr. 2-1843, datë 16.05.2017. Komisioni Shtetërorë për Diplomim, i cili në pikat 1 dhe 2 thekson: “1. Të gjithë studentët që kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë dhe që i nënshtrohen provimit të diplomimit/maturës duhet të paraqesin dëshmi nga banka se kanë paguar shumën prej 5 euro. 2. Pagesa përdoret si dëshmi për pjesëmarrjen në provim shtetëror.” Ky Vendim nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara me Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore.

Avokati i Popullit, me datë 4 maj 2018 ka dërguar tek Ministri një raport me rekomandime duke kërkuar anulimin e atij vendimi, pasi që konsiderohet si jologjor dhe shkel të drejtat e njeriut. Me datë 14.05.2018, në përgjigje zyrtare të Ministrit, IAP është informuar që rekomandimi është zbatuar dhe vendimi është anuluar. Avokati i Popullit iu referua nenit 21 pika 1.5 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019 dhe vendosi të ndërpres hetimet në lidhje me këtë rast me datë 21 qershor 2018, pasi që është zgjidhur në mënyrë pozitive.

## **4. Ankesa nr. 670/2017 –apel kundër Komunës së Pejës**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar një apel kundër Komunës së Pejës në të cilin apeluesi ka deklaruar se ka marrë informata jozyrtare nga një njohur se një nga parcelat që ai zotëronte ishte shitur dhe përdorur si një parcelë ndërtimi dhe se dëshiron një pasqyrë nga regjistrat kadastral lidhur me pronën e tij dhe këtë situatë të pretenduar.

Në lidhje me pretendimet në ankesë, IAP i është drejtuar Komunës së Pejës/Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi dhe ka kërkuar informata në lidhje me gjendjen e patundshmërisë.

IAP pranoj informacion nga Komuna e Pejës që një transferim i pronës është kryer në bazë të kontratës së shitblerës në mes të personave (R (P) T dhe H (U) A), derisa pjesa tjetër e pronës është ende në emër të babait të ankuesit. Përveç përgjigjes së marrë, gjithashtu janë bashkangjitur kopjet origjinale nga zyra e kadastrës në lidhje me parcelat e lartpërmendura.

Me datë 21 shkurt 2018, ankuesi u informua për përmbajtjen e përgjigjes së marrë dhe i është paraqitur dokumentacioni shoqërues.

Procedura u përmyll në pajtim me kërkesën e palës dhe Avokati i Popullit në pajtim me nenin 21, paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 05/L-019, vendosi të ndërpresë hetimin në lidhje me çështjen e lartpërmendur pasi që ishte zgjidhur pozitivisht.

## **5. Ankesanr. 97/2017 kundër Komunës së Suharekës**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar apel në lidhje me tokën në pronësi të një familje e cila ishte shpronësuar nga ana e komunës së Suharekës për qëllim të ndërtimit të rrugës/trafikut, por askush nga familja nuk ishte informuar e as nuk ka ushtruar të drejtën e tyre për shpronësimin e tokës, si dhe nuk ka informacion në lidhje me gjendjen aktuale të pronës e cila dikur ishte e regjistruar në emër të kreut të familjes.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit, IAP iu është drejtuar komunës së Suharekës, përkatësisht Drejtorisë për kadastër dhe ka kërkuar informacion në lidhje me procesin e shpronësimit të tokës si dhe informacion në lidhje me gjendjen e pasurisë sëpatundshme në pronësi të familjes ankuesit.

Me datë 3 maj 2017, Avokati i Popullit pranoj një përgjigje nga komuna e Suharekës – pasardhësi, i cili theksoj se në lidhje me këtë rast në regjistrat kadastral toka ishte e regjistruar në emër të kreut të familjes gjë e cila ishte verifikuar nga eksperti i komunës së Suharekës për kadastër dhe gjeodezi, po ashtu u konstatua se prona në fjalë është e paprekur dhe se nuk ka ndërtim në të dhe sa i përket gjendjes së pronës në pronësi të familjes në fshatin Mushishtë, ata gjithashtu dorëzuan kopjet e planeve dhe kopjet nga kadastrë në emër të familjes kërkuese.

Duke pasur parasysh se rasti është në përputhje me kërkesën e Apeluesit, sipas nenit 21, pika 1.5 e Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit vendosi ta ndërpresë hetimin për këtë rast pasi që ishte zgjidhur pozitivisht.

## 6. Ankesa nr. 920/2017 kundër Qendrës për Regjistrim Civil - Pejë

Apeluesi në apelin e tij deklaroi se iu është drejtuar Qendrës së Regjistrimit Civil në Pejë me qëllim të marrjes së dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e dokumenteve personale/dokumenteve nga Regjistri Qendror me numrin personal të identifikimit dhe shtetësisë, por pa sukses.

Lidhur me pretendimet në ankesë, IAP kontaktoi Zyrën e Gjendjes Civile, i njoftoi ata për ankesën, dërgoi dokumentacionin e paraqitur nga ankuesi dhe kërkoi informata nëse dhe çfarë duhet të plotësojë apeluesi nga dokumentacioni në mënyrë që të marrë dokumentin e kërkuar. Zyra e regjistrimit civil u përgjigj dhe shpjegoi se çfarë nevojitet për t'i dhënë apeluesit dokumentet e kërkuara.

Pas informimit të parashtruesit të ankesës dhe dhënies së udhëzimeve të marra për ankuesin, ai arriti të marrë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kërkesën e Apeluesit, dhe sipas nenit 21, pika 1.5 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit vendosi ta ndërpresë hetimin në këtë rast pasi që ishte zgjidhur me sukses.

## 7. Ankesanr. 21/2018 kundër Komunës së Prizrenit

Në bazë nenit 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, me datë 17 janar 2018 Avokati i Popullit pranoi apel kundër Komunës së Prizrenit – Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave pronësore të apeluesit mbi pasurinë e patundshme e cila gjendet në Prizren. Për këtë qëllim, apeluesi kërkoi ndërmjetësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit tek Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në kuadër të Komunës së Prizrenit për të parandaluar lëshimin e një akti pronësor personit të dënuar për lidhjen e marrëveshjes sëshitblerës, përmes së cilës i dënuari ka tentuar që të marrë pronën e paluajtshme dhe shtëpinë e familjes së apeluesit në mënyrë të paligjshme.

Me datë 24 janar 2018, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka bërë një vizitë zyrtare në lidhje me rastin e ankuesit, i cili u informuar nga Zëvendës drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Prizrenit që kjo zyre tashmë ishte informuar për rastin e ankuesit nga ana e Gjykatës Themelore të Prizrenit e cila ka dërguar Vendimin C. nr. 777/10 datë 27 dhjetor 2017, me të cilin vendim Gjykata ndërpreu masën e përkohshme të vendosur paraprakisht për ndalimin e shpronësimit të pronës në fjalë dhe apeluesit iu dha e drejta për të përdorur lirshëm pasurinë e tij. Në këtë vendim u shpjegua se ky rast ka përfunduar me vendim përfundimtar në favor të apeluesit. Një kopje e vendimit të gjykatës iu dorëzua edhe përfaqësuesit të Avokatit të Popullit.

Në po të njëjtën ditë, këshilltari ligjor përgjegjës i Avokatit të Popullit e informoi ankuesin për përgjigjen e palës përgjegjëse dhe më 21 qershor 2018, meqë rasti i ankuesit ishte zgjidhur sipas nenit 21, paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. /L-019 mbi Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit vendosi ta ndërpresë hetimin për këtë rast pasi që ishte zgjidhur me sukses.

## 8. Kërkesanr. 402/2017, kundër Prokurorisë Themelore në Gjakovë

Bazuar në nenin 16.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Nr. 05/L-019, me datë 26 maj 2017, është pranuar një apel për shkak të kohëzgjatjes së procedurave pranë Prokurorisë Themelore në Gjakovë në lidhje me një padi penale të parashtruar me ankesë me datë 7 qershor 2013, lidhur me uzurpimin e paligjshëm të pronës së paluajtshme.

Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit (AP), pasi që analizoj dokumentacionin e apeluesit, konstatoi që pas hetimit të kryer në padinë penale, prokuroria ka ngritur aktakuzë PP.nr. 1035/2013 datë 15 korrik 2013 kundër të akuzuarit për veprën penale për uzurpim të paligjshëm të pasurisë së paluajtshme. Në bazë të nenit 363, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i KPK-së, Gjykata Themelore në Gjakovë hodhi poshtë padinë kundër të akuzuarit sepse u konstatua se prona në fjalë në lidhje me të cilën është iniciuar vepra penale është në pronësi të Komunës të Gjakovës, që do të thotë se Komuna e Gjakovës është mbajtës i së drejtës së pronës mbi pasurinë e kontestuar, e cila u vendos nga Kuvendi Komunal që nga 1 tetori i vitit 2001, kur bashkëshortes së të akuzuarit iu dha në shfrytëzim të përkohshëm prona.

Në bazë të informacionit të siguruar, Avokati i Popullit konstaton se Prokuroria Themelore në Gjakovë ka vepruar në bazë të një ankese penale të kontestuar në pajtim me ligjin dhe pa asnjë vonesë, kështu që çështja ndiqet brenda një afati të arsyeshëm dhe nuk tregon ekzistencën e shkeljes së drejtës së dëgjimit brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe shkeljessë nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Bazuar në sa më sipër, Avokati i Popullit me datë 29 dhjetor 2017, në bazë të nenit 22, paragrafi 1.1 të Ligjit për Avokatit të Popullit, Nr. 05/L-019 vendosi të ndërpresë hetimin për këtë rast - nuk janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut ose nuk është kryer ndonjë keq menaxhim.

Sipas nenit 25, (Detyrimi i bashkëpunimit dhe pasojat e refuzimit):

1. “Të gjitha autoritetet kanë për obligim t’i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij”.
2. “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.
3. “Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare”.

### • **NDIKIMI DHE MOSZBATIMI I REKOMANDIMEVE NGA ANA E AVOKATIT TË POPULLIT**

Organet e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut me kompetenca të ngjashme nuk kanë mundësi që drejtpërdrejtë t’i zbatojnë rekomandimet e tyre. Kjo është arsyeja sepse një juridiksion i tillë

konsiderohet një kombinim papranueshëm i punëve hetimore dhe punëve kuazi-funksionale të të njëjtin organ. Në një mendim Komisioni i Venecias thekson:

"Nga vetë natyra e Institucionit të Avokatit të Popullit mund të jepen vetëm rekomandime. Nuk mund të ketë udhëzime për të ndjekur këto rekomandime. Mirëpo, do të ishte me të vërtetë e nevojshme që organet administrative që janë përgjegjëse të reagojnë ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, duke i pranuar dhe korrigjuar rekomandimet ose duke ofruar një justifikim në rast të refuzimit të "rekomandimeve të Avokatit të Popullit".

U regjistrua një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të pazbatuara të zyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës në fushën e diskriminimit, disa nga rastet datojnë që nga viti 2009 kryesisht raste të të drejtave pronësore dhe shfrytëzimit të të drejtave pronësore.

Nga 18 raste të përfunduara në vitin 2017 në lidhje me diskriminim, vendime përfundimtare janë marrë në vazhden e 12 rasteve, derisa ishin dy raste për inicim të hetimeve pas të cilave janë lëshuar rekomandime për shkelësit për marrjen e masave që do ta parandalojnë diskriminimin. Nga ky numër, 6 rekomandime janë zbatuar; dy janë zbatuar pjesërisht, 8 nga 18 rekomandime fare nuk janë zbatuar. (Statistikat nga raporti i IAP për vitin 2017).

Statistikat e rekomandimeve të pazbatuara janë si në vijim:

Me rastin e 4 rasteve, u zhvillua një takim, në të cilin u përsëritën rekomandimet: Për 2 rastet nuk ka përgjigje dhe 2 raste mbeten pa realizim. (Statistikat formojnë raportin e IAP-së për vitin 2017).

Për më tepër, sipas intervistës së bërë me zyrën e Avokatit të Popullit dhe departamentet e tij ligjore gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, zyra e Avokatit të Popullit ka pranuar 1.001 ankesa nga qytetarët e Kosovës, sipas zyrës së Avokatit të Popullit në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për Avokatin e Popullit nga ky numër 566 ankesa nuk janë të pranueshme dhe 444 ankesa u pranuan dhe u shpërndanë tutje në mes të departamenteve të ndryshme. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2018, zyra e Avokatit të Popullit zgjidhi 121 raste me rezultate pozitive, ndërsa 323 janë ende në proces të zgjidhjes.

Në mënyrë që të sigurohet pasqyra e duhur e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, zyra ka ofruar disa nga rastet e pazgjidhura për paraqitjen e punës dhe disa nga rastet të cilat nuk janë zgjidhur por janë ende nën mbikëqyrjen e Avokatit të Popullit derisa rezultatet pozitive nuk janë marrë:

### **1. Ankesa nr. 357/2017 –Gjykata Themelore në Prishtinë**

Institucioni i Avokatit të Popullit me datë 04.05.2017 pranoi një apel me pretendim që apeluesi është pronar i tokës e cila gjendet në Fushë Kosovë, në zonën e rrugës së Vojvoda Bojoviq, me sipërfaqe prej 0.89.68 ha e regjistruar në pronësi me parcelën nr. 682. Prona është e regjistruar në emër të babait të ndjerë të të ankuesit. Sipas Apeluesit, gjatë vitit 1999 prona nga personat e tretë në mënyrë të paligjshëm është shkelur dhe uzurpuar në bazë të dokumenteve të falsifikuara,

ankuesi ka parashtruar një kërkesë penale me datë 18 shtator 2007. Zyra e Prokurorisë kompetente e regjistroi rastin sipas numrit K.br.210/09, dhe pas procedurës së iniciuar, dhe ngritjes së një kallëzimi penal, filloi procedura penale në Gjykatën Themelore të Prishtinës, rezultati i këtij rasti nuk iu ështëshpallur/paraqitur ankuesit deri në korrik të vitit 2017. IAPme datë 29.05.2018 publikoi raportin me rekomandim. Lidhur me këtë rast dhe deri më tani rasti nuk është zbatuar ose rekomandimi i IAP nuk është marrë parasys.

## **2. Apeli nr. 864/2017 –kundër Gjykatë së Apelit**

Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të nenit 16.1 Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, me datë 09 dhjetor 2017 pranoi një apel me ankesë për kohëzgjatjen e procedurave përballë Gjykatës së Apelit dhe në bazë të rastit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 1972/13. Lënda e apelit ka të bëjë me punësimin dhe apeluasi kërkon që rastit t'i jepet prioritet në zgjidhje. Mirëpo, edhe pas kalimit prej më shumë se 5 vjetësh, shqyrtimi i tij ende nuk ka filluar. Një raport me rekomandim nga IAP u publikua me datë 29 maj 2018 dhe ende nuk është zbatuar.

## **3. Ankesa nr. 303/2018 kundër Komunës së Zubin Potokut**

Institucioni i Avokatit të Popullit pranoi një ankesë ku thuhet se kërkesa zyrtare për Komunën e Zubin Potokut në lidhje me marrjen e kopjeve të dokumentacionit të vendosur në arkivat e komunës është parashtruar por nuk është pranuar.

Avokati i Popullit në dy raste i dërgoi një letër kryetarit të Komunës së Zubin Potokut, por nuk mori ende përgjigje. Më shumë gjasa do të lëshohet një raport i jo bashkëpunimit ose një letër rekomandimi.

- **Ndihma ligjore (e KUFIZUAR)**

Sipas shpjegimit të përfaqësuesit të Institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, ky institucion shpesh është shkalla e parë ku individëadresojnëçështjet e tyre. Disa personai adresohen zyrës kur tashmë i kanë iniciuar procedurat gjyqësore dhe kërkojnë monitorimin e gjykimeve, disa i drejtohen me kërkesës për ndihmë dhe këshilla juridike kur iniciojnëprocedura gjyqësore, dhe disa në situata kur tashmë iu janë adresuar disa organeve drejtuese, por nuk kanë mundur të zbatojnë të drejtën e tyre në procedurat e përfunduara të cilat i kanë arritur përmes sistemit ligjor.

Shtirja e ndihmës juridike që Institucioni i Avokatit të Popullit mund t'u ofrojë viktimave të diskriminimit është e kufizuar nga problemi strukturor i paarritshmërisë së shërbimeve të tij në tërë territorin e Kosovës. Edhe pse janë shtatë zyre rajonale në të gjitha pesë regjione, ende qëndron nevoja për zyre shtesë (veçanërisht në veri të Kosovës) dhepër më shumë kampanja për rritjen e dukshmërisë me qëllim që qytetarët të adresojnë problemet e tyre dhe të kërkojnë të drejtat e tyre në zyra rajonale. Punëtorët e zyrave rajonale, sikurse edhe ata të zyrës qendrore në Prishtinë, përmbushin mandatin e IAP, mbrojnë, mbikëqyrin dhe promovojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ofrojnë këshilla dhe udhëzime në lidhje me të drejtat e qytetarëve dhe mekanizmat e mundshëm mbrojtës, por qytetarët duhet të jenë më të përfshirë në fushatat e

ngritjes së vetëdijes ku mund të mësojnë rolin e IAP dhe cilat të drejta mund të kërkojnë dhe mbrojnë nëpërmjet ndihmës së Zyrës së Avokatit të Popullit.

## KAPITULLI 6

### PËRFUNDIM

Korniza ligjore siguron një platformë cilësore për rolin e rëndësishëm të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë në luftën kundër diskriminimit. Megjithatë, ka probleme me rekomandimet që Zyra e Avokatit të Popullit po i jep institucioneve publike dhe hezitimet e tyre dhe vonesat në zbatimin e rekomandimeve të ofruara nga Zyra e IAP-së, potencialet dhe puna e mirë e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe mandati i tij i themeluar gjerësisht nuk mund të reduktohet dhe përpjekjet që IAP po i bënë në mbrojtje kundër diskriminimit mund të trajtohet si pozitive dhe janë të mirëpritura nga qytetarët. Në këtë drejtim, ne jemi përpjekur të identifikojmë problemet themelore në këtë hulumtim, të cilat duhet të adresohen në periudhën e ardhshme. Organet për mbrojtjen e barazisë mund të jenë një mjet efektiv për të mbrojtur individët nga diskriminimi - të specializuara dhe të disponueshme. Duke i sjellë ato me mbrojtje gjyqësore, mund të jenë një mënyrë më e thjeshtë, më e shpejtë dhe më efikase për të fituar mbrojtje nga diskriminimi. Këto organe zhvillojnë një ekspertizë dhe përvojë të veçantë dhe me kalimin e kohës mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në ligj dhe në zbatimin e tij. Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, të cilit i është caktuar roli i institucionit për mbrojtjen nga diskriminimi, mund të bëhet një katalizator i vërtetë për ndryshimet shoqërore në këtë fushë, megjithatë, është e nevojshme që të sigurohen kushtet për punën e pandërprerë, të pavarur dhe efektive.

Nga ana tjetër, në kushtet e kulturës së pazhvilluar të sundimit të ligjit, rekomandimeve të tij jo gjithmonë iu është kushtuar kujdes, me mungesën e mbështetjes së nevojshme nga akterët e tjerë kyç në përmirësimin e zbatimit të rekomandimeve të paralizuar. Në këtë mënyrë, dhe mungesa e mbështetjes për forcimin e autoritetit të këtij institucioni mbetet të trajtohet/preket.

## KAPITULLI 7

### REKOMANDIMET

Duke përdorur mjete të siguruar në mënyrë optimale, është i domosdoshëm forcimi i kapaciteteve të personelit të Departamentit të Avokatit të Popullit për eliminimin e të gjitha formave potenciale të diskriminimit, me anë të formimit të një ekipi punonjësish dhe riorganizimit të departamentet në drejtim të krijimit të sektorëve të posaçëm për punë me ankesa, hulumtime dhe zhvillime, njoftimin e raporteve dhe publikimeve, dhe përgatitjen e analizave statistikore të çështjeve normative-ligjore.

Në mes të punonjësve që merren me raste specifike është e dëshirueshme të shpërndahen kompetencat sipas njohurive dhe përvojës individuale, veçanërisht në rastet e rëndësishë së lartë, ose shpërndarjen e rasteve të ankesave individuale të përfaqësuara në baza diskriminuese, të cilat do të siguronin ndihmë afatgjatë, me një kosto minimale dhe edukim të vazhdueshëm të të punësuarve, si dhe do të sigurojë zhvillimin dhe ekspertizën e personelit të punësuar në fushat specifike të ligjit dhe shkeljeve të ligjit.

Përveç kësaj, prania e zgjeruar Avokatit të Popullit në teren duhet të sigurohet duke hapur nën-zyra të reja dhe shpalljen e fushatave të ndërgjegjësimit publik ku institucioni i Avokatit të Popullit do të shihet si përgjegjës dhe i përgjegjshëm për të ndihmuar qytetarët dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre.

Kjo në një anë do të forcojë disponueshmërinë e shërbimeve të Institucionit për individët në tërë territorin e Kosovës dhe nga ana tjetër do të krijojë kushte për zbatimin më efikas të aktiviteteve të tjera të rëndësishme - hetime, procedura të monitorimit dhe ngritje të vetëdijes në fushën e luftimit të diskriminimit, veçanërisht në institucionet publike.

Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet promovimit të inovacioneve dhe rezultateve, duke u fokusuar në mundësinë e mbrojtjes nga diskriminimi në sektorin privat, rregullat mbi transferimin e barrës së provës, ndalimin e viktimizimit dhe përgjegjësisë për kundërvajtje të parapara me ligj. Kjo mund të ketë një efekt të dyfishtë pozitiv - inkurajimin e viktimave për të parashtruar ankesa dhe për të dekurajuar shkelësit potencial nga veprimet e paautorizuara. Për më tepër, do të edukojë publikun e gjerë, kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse do të informojë çdo person të identifikuar si diskriminues potencial për ndalimin e viktimizimit të personave të përfshirë në procedura dhe për sanksionet që mund të pasojnë. Nga ana tjetër, një sqarim në kohë i barrës së provës zakonisht do të krijojë një nxitje për të ofruar përgjigje dhe bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit për qëllime të mbrojtjes adekuate dhe mbrojtjes së të drejtave.



## REFERENCAT

1. Institucioni i Avokatit tē Popullit(<https://oik-rks.org/sr/pravni-akti>)
2. Ligji pēr Mbrojtjen nga Diskriminimi  
(<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-021%20s.pdf>)
3. Raporti vjetor i Institucionit tē Avokatit tē Popullit (<https://www.oik-ks.org/en/2018/03/30/annual-report-2017>)
4. Komisioni i Venecias ([https://ëëë.coe.int/en/ëëb/strengthening-the-human-rights-ombudsman-to-fight-discrimination-disco-/-/asset\\_publisher/GHMoSbFjVXpc/content/seminar-for-judiciary-antidiscrimination-standards](https://ëëë.coe.int/en/ëëb/strengthening-the-human-rights-ombudsman-to-fight-discrimination-disco-/-/asset_publisher/GHMoSbFjVXpc/content/seminar-for-judiciary-antidiscrimination-standards))
5. [http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Rregullorja\\_01-2016\\_ang\\_528820.pdf](http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Rregullorja_01-2016_ang_528820.pdf)

Gusht2018  
Mitrovica e Veriut



**PËRMBLEDHJE  
E POLITIKAVE**

**Avokati i Popullit në sistemin e  
mbrojtja kundër diskriminimit**

**PËRMBLEDHJE  
E POLITIKAVE**



*Përmbajtja e kësaj Përmbledhje të politikave  
nuk pasqyron opinionin zyrtar të donatorit.  
Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet  
e shprehura në këtë Përmbledhje të politikave  
bie tërësisht mbi autorët e këtij dokumenti.*



Kingdom of the Netherlands



Advocacy Center For Democratic Culture

